



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 748, datë 18.12.2024**

PËR

**CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDIMIN DISIPLINOR NR.
6/2024, TË FILLUAR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, NDAJ
MAGJISTRATES ZNJ. {...} ME FUNKSION GJYQTARE NË GJYKATËN E
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes, relacionin e përgatitur, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, znj. Emona Muçi, në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 6/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistrates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR